

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	A po lind pas Hagës një kauzë e re shqiptare?
ADRESA	https://www.koha.net/opinion/a-po-lind-pas-hages-nje-kauze-e-re-shqiptare
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 05:13:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 15:08:53 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0677b4da83a369727ed85c3c47d9e10c58a7f20aab08d5355622df8bbdabfb22
TEKSTI	919392007965d9d298a0f0261eedb59195fa3284902644f3896285d2017a5c2e
PAMJA	8cd51b12de9fd4d3cfc2eddcc53d0d1d9dcb0b6dec29ec71a0544dfebb38a6b1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8d3477bdfb381e7c2f922dfa2527b406ae59a08a8c4ae9f845383c97d7ecfe36
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8d3477bdfb381e7c2f922dfa2527b406ae59a08a8c4ae9f845383c97d7ecfe36>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

OPINION

A po lind pas Hagës një kauzë e re shqiptare?

Nga: Fadil Maloku

22 shtator 2026 17:08

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi
t'i lexoni lajmet e fundit dhe
të përzgjedhura në kanalin
tonë zyrtar në Viber

Protesta, nëse arrin të “çlirohet” nga prangat e kornizave tradicionale partiake, ajo, në fakt, do të arrijë të krijojë kondita të reja “negociuese”, si me Serbinë, ashtu edhe me qendrat e reja vendimmarrëse që po shihet se kanë marrë si formë, ashtu edhe përmbajtje, tejet dalluese nga ato të pasluftës

1.

Duket që Serbia dhe arkitektët e djallëzuar të Aktgjykimit drakonik të Hagës, që kanë parashikuar, por që, dorën në zemër, edhe kanë punuar me zell për këto gati tri dekada, që të ndodhë një polarizim i skajshëm, po edhe një fragmentim identitar, apo një përçarje e madhe, e ndoshta edhe një skenar apokaliptik në formë të një lufte civile, do të ndahen të zhgënjyer. Sepse, anipse ne si shoqëri, në ndërkohë, ishim të zhytur në deliriumin e vetëkënaqësisë kolektive që e prodhoi akti i shpalljes së pavarësisë, ai i fillimit të procesit të shtetdërtimit, protestat që po organizohen aktualisht duket që shpresën e Serbisë për fragmentim, përçarje e polarizim, në gjykimin tim sociologjik, do ta prolongojnë edhe për një kohë. E them kështu edhe për shkak se këto protesta ka shumë gjasa që të mund të konvertohen, midis tjerash, në dy binarë linearë. Binari i parë, që mua po më duket se veç është kah merr formën e një homogjenizimi emocional e kombëtar dhe të një potenciali pozitiv për konsolidim. Dhe binari i dytë, që mund të na çojë në një rrezik potencial për polarizim e tension të shfrenuar rajonal, ku Serbia këtë aktgjykim do ta përdorë në të gjitha forumet vendimmarrëse për të vazhduar më tej kontestimin e shtetësisë.

2.

Ajo çfarë jam kureshtar ta di dhe kuptoj në këtë rast ka të bëjë me hipotezën se a mundet një aktgjykim (politik) i tillë gjyqësor, përtej dimensionit të tij juridik, të prodhojë pasoja të thella sociologjike mbi shoqërinë e frustruar tashmë kosovare? Dhe a mundet ky aktgjykim i Gjykatës Speciale të Hagës të shndërrohet me lehtësi në një lloj katalizatori të ri homogjenizues kombëtar gjithëshqiptar? Pra, thënë edhe më thjeshtë: a mundet ky aktgjykim të kapërcejë kufijtë e Kosovës dhe të prodhojë një kauzë të re në gjithë hapësirën ballkanike që do t'i përshtatej edhe rendit të ri global që veç ka nisur të vijëzohet me ardhjen e Donald Trumpit në Zyrën Ovale amerikane? Janë këto dilema "hamletiane", por jo edhe të pamundura, nëse kihet parasysh se dikush konsideron apo ka edhe plane konkrete dhe vlerëson se ka ardhur koha e bashkimit të të gjitha trojeve shqiptare? Po themi kështu, gjithnjë duke u bazuar në një fakt të ditur sociologjik, se rrethanat sociopolitike, kur bashkëdyzohen me kriza moralo-politike, ato shumë shpejt dinë t'i determinojnë, po edhe përcaktojnë zhvillime dhe procese të caktuara politike, po edhe krijimin e konditave të reja për një narrativë të re mobilizuese, e madje edhe liderë të rinj. Pyetja jonë, në fakt, nuk është thjesht retorike, sepse protestat që po vazhdojnë pandalur në Prishtinë pas aktgjykimit, në një mënyrë, po tregojnë se kemi të bëjmë me një proces që nuk mund të shpjegohet vetëm me kategoritë e zakonshme të reagimit emocional politik. Ajo që po ndodh, mua po më duket se këtu kemi të bëjmë, midis tjerash, edhe me një narrativë të re, e që në njëri si një proces i pakënaqësisë enantopane

Arbëri.

Kallas takon Kurtin e Vuçiqin: Koha për të ecur përpara

Arbëri.

Haradinaj: Këto protesta kaq të qeta po më frikësojnë, revolta po mbledhet

Arbëri.

Haradinaj: Behajdin Allaqi u përmend për të krijuar huti dhe përçarje

Kulturë.

Enver Petrovci – artisti që largohet nga jeta, por jo edhe nga skena

Arbëri.

Arrestohet në Maqedoninë e Veriut ish-luftëtar i UÇK-së, Fadil Pushkolli

Futboll.

Kosova vazhdon përgatitjet për duelin ndaj Irlandës

identitare e simbolike, por që po interpretohet nga një pjesë e konsiderueshme e shoqërisë jo më si dënim drakonik i individëve, por si një ngjarje që prek në thellësi një pjesë të kujtesës kolektive të luftës, të çlirimit dhe të vetë shtetformimit të Kosovës.

3.

Edhe
Opinion • 22 maj 2026
Xhandarmëria kosovare, nga iluzioni i mbrojtjes
ndërkombëtare te ambicia për shtet relevant në rajon

Dhe nëse bëjmë pyetjen e radhës, se ku qëndron ai paradoksi i parë sociologjik i krejt kësaj arkitekture protestuese? Pra, cilat janë shanset që shoqëria aktgjykimet individuale për secilin veç e veç t'i përfjethë dhe perceptojë si aktgjykim për krejt luftëtarët e UÇK-së? Pra, në këtë ekuacion, ku përgjegjësia individuale juridike fillon të katapultohet apo transferohet në terrenin e një përjetimi më të gjerë kolektiv, ashtu siç po e manifestojnë protestuesit gjatë këtyre ditëve, gjasat për një dinamikë të re dhe një narrativë të munguar opozitare në gjithë këto vjet të paraluftës, janë më se reale. Dhe është pikërisht kjo mënyrë e reagimit ajo arsyeja se përse protestat në Prishtinë nuk duhen parë vetëm si reagim spontan ndaj një aktvendimi gjyqësor. Megjithatë, në gjykimin tim, protesta, nëse arrin të "çlirohet" nga prangat e kornizave tradicionale partiake, ajo, në fakt, do të arrijë të krijojë kondita të reja "negociuese", si me Serbinë, ashtu edhe me qendrat e reja vendimmarrëse që po shihet se kanë marrë si formë, ashtu edhe përmbajtje, tejtej dalluese nga ato të pasluftës. Mirëpo, nëse mbetet vetëm rob i interesave klanore, grupe, partiake e ideologjike, e jo edhe interesave strategjike të Republikës, protesta, jam shumë i bindur, që do të mbetet vetëm një ikonografi partiake dhe një folklorizëm i dështuar defrustrues, e asgjë më shumë.

(Autori është sociolog)

#FADIL MALOKU

Artikuj të ngjashëm



Arbëri • 20 sht 2026
Disa sugjerime për konstatim të përbashkët të gjendjes pas Aktgjykimit të 16 shtatorit



Arbëri • 19 sht 2026
Organizatorët apelojnë te partitë të mos i politizojnë protestat kundër vendimit të Speciales



Arbëri • 17 sht 2026
Ukshini: Me vendimin e Hagës rruga e Kosovës në planin ndërkombëtar do të jetë e vështirë



Arbëri • 17 sht 2026
Aktgjykimi në Hagë - mundësi për afrimin e partive e tejkalimin e ngërçit institucional

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing
Politika e privatësisë
Kushtet e përdorimit
Udhëzimet për përdorimin e IA-së
Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i Ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh
Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.